

## RELACION

### PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR RATIFIKIMIN**  
**E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE**  
**TË MAQEDONISË DHE KOMISIONIT EVROPIAN,**  
**PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT**  
**NDËRKUFITAR IPA II, ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE**  
**E MAQEDONISË -REPUBLIKA E SHQIPËRISË, 2014-2020,**  
**ALOKIMET E VITIT 2017**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është të propozojë ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë<sup>1</sup> dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë-Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Komisioni Evropian, më 16.1.2018, nga Maqedonia, më 13.3.2018, dhe nga Shqipëria, më 28.8.2018.

Programi BNK Maqedoni-Shqipëri, 2014-2020, u miratua nga Komisioni me vendimin zbatues C (2014) 9674, të datës 11 dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit Evropian, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 190 000 eurosh, për të dyja vendet, por, duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të të dyja shteteve, buxheti i përgjithshëm i programit, për vitin 2017, arrin vlerën e 1 400 000 eurove.

Sqarojmë se, në total, kontributi që do të japë Bashkimi Evropian për zbatimin e përbashkët të programit Maqedoni-Shqipëri, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën e 11 900 000 eurove, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Maqedonisë dhe Komisionit Evropian. Sjellim në vëmendje se, tri marrëveshje të tjera financimi janë konkluduar mes këtyre palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014 dhe 2015 dhe alokimet e vitit 2016), të cilat janë miratuar me vendimet nr.1088, datë 28.12.2015, dhe nr. 341, datë 17.4.2017, të Këshillit të Ministrave.

---

<sup>1</sup> Referenca “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë” bëhet për shkak se ky është termi zyrtar me të cilin i referohet Bashkimi Evropian dhe i tillë përdoret edhe në tekstin e marrëveshjes.

Përfitues të këtij programi janë zonat, si më poshtë vijon:

Në Maqedoni: Rajoni i Pelagonias, Rajoni i Pologut, Rajoni Jugperëndimor.

Në Shqipëri: Qarku i Dibrës, Qarku i Elbasanit, Qarku i Korçës.

Programi i bashkëpunimit Maqedoni-Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program, mbështet gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive midis përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga këto 5 pjesë:

- i. Shtojca I: Programi i veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar (BNK) Maqedoni-Shqipëri për vitet 2015-2017;
  - ii. Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë;
  - iii. Shtojca II: Kushtet e përgjithshme;
  - iv. Shtojca III: Modeli i raportit vjetor BNK për zbatimin e asistencës IPA II (në përputhje me nenin 80 të marrëveshjes kuadër);
  - v. Shtojca IIIA: Modeli i raportit vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, në përputhje me nenin 58 të marrëveshjes kuadër.
- Programi i veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Shqipëri, për vitet 2015-2017 (shtojca I), përmban një përshkrim të modaliteteve të zbatimit të programit, përfshirë alokimet për secilin vit financiar, prioritetet e programit, kushtet e thirrjeve për projektpropozime dhe monitorimin e performacës së programit.
  - Programi i bashkëpunimit (shtojca IA) përmban një analizë të karakteristikave kryesore të territorit të lejueshëm, të prioritetëve dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta.

- Një pjesë e rëndësishme e marrëveshjes janë edhe kushtet e përgjithshme (shtojca II), ku parashikohen, përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit. Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shkup.
- Shtojcat III dhe IIIA të marrëveshjes paraqesin modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë, pavarësisht zbatimit nën menaxhimin indirekt apo direkt nga ana e Komisionit Evropian.

Maqedonia dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë ngushtë me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shkup (autoriteti kontraktues) për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (DBE në Shkup), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik, si dhe Koordinatorët Kombëtarë të fondeve IPA të të dyja vendeve përfituese.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë, sipas prioriteteve të përcaktuara në program, duke u mundësuar, në këtë mënyrë, aktorëve rajonalë dhe vendorë nga të dyja vendet, të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme dhe një efekt të matshëm për sektorin socio-ekonomik.

Programi i bashkëpunimit Maqedoni-Shqipëri ka reflektuar rëndësinë që Bashkimi Evropian u kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale. Çështje të tilla janë reflektuar në të gjitha prioritetet e zgjedhura për programin, si: krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve dhe të kategorive të cënueshme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore etj.

Në lidhje me evidentimin e problematikave, ashtu si në çdo program tjetër të bashkëpunimit ndërkufitar, problematika kryesore pas miratimit të projektligjit do të lidhet kryesisht me mundësitë dhe kapacitetet e përfituesve shqiptarë për përthithjen, hartimin e projektpropozimeve dhe zbatimin me sukses të projekteve të financuara nga ky program. Ndaj, në vazhdim, puna e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme do fokusohet në mbështetjen e përfituesve shqiptarë për hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të projekteve.

Aktualisht, programi ka lançuar një thirrje për projektpropozime, nga ku kanë rezultuar fituese 8 projekte, me një përfshirje prej 13 partnerësh shqiptarë. Thirrja e radhës për projektpropozime do të lançohet rreth muajit nëntor 2018, ku do të përdoren edhe alokimet e vitit 2017 që synohen të miratohen me këtë projektligj.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i Këshillit të Ministrave është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe me nenet 8 e 10, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr.37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk përafron në vetvete ndonjë akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë -Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017, me një vlerë prej 1 190 000 eurosh për të dyja vendet. Ky buxhet do të përdoret për financimin e projekteve sipas akseve prioritare të përshkruara në pikën 1 të këtij relacioni. Projektet përzgjidhen pas një procesi transparent aplikimi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet për zbatimin e vendimit.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Në lidhje me zbatimin e ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, theksojmë se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka marrë nismën për konsultimin publik të përmbajtjes së programit, duke bërë publike, në faqen zyrtare të ish-Ministrisë së Integritetit Evropian, të gjitha dokumentet apo edhe draft-dokumentet, për të cilat është gjykuar se mund të ketë interes publik. Procesi i përgatitjes dhe konsultimit të programit filloi në korrik të vitit 2013, duke vazhduar deri në maj 2014, kur edhe u dërgua drafti final për miratim nga ana e Komisionit Evropian.

Gjithashtu, nënvizojmë se në rastin e lançimit të thirrjes për projektpropozime, Ministria për Evropën dhe Punët e jashtme e shpall atë *on-line* dhe organizon ditë informuese në zonat e lejueshme të programit.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ende nuk mund të shprehem saktësisht lidhur me efektet konkrete financiare në buxhet, por, duke marrë parasysh se përfitimi financiar i të dyja vendeve do të jetë përafërsisht i barabartë, pritet që vendi ynë të përfitojë shumë prej rreth 600 000 eurosh nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Theksojmë se përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore, por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse (të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore). Sjellim në vëmendje se raporti i financimit të çdo projekti të financuar nga kjo marrëveshje (përveç projektit të asistencës teknike) është në raportin 85% grant i Bashkimit Evropian dhe 15% bashkëfinancim kombëtar. Projektet fituese përcaktohen pas vlerësimit të aplikimeve që dorëzohen nga aplikantët gjatë fazës së thirrjes për projektpropozime.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**